



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.173/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore, Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit LDK-AKR dega në Gjilan, për shkak të vendosjes së posterit në drunjë të qytetit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, dhe koalicionit LDK-AKR dega në Gjilan, i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 2.800 (dymijë e tetëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 05.06.2017, nga Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur një parregullsi të cilën e kanë evidentuar me fotografi të printuara nga vendi i ngjarjes. Parashtresi i ankesës potencon se me datën 07.06.2017, në rrugën kryesore të qytetit “Idriz Seferi”, në Gjilan, në afërsi të spitalit rajonal, monitoruesi i tyre ka hasur në një poster të kandidatëve për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e koalicionit në fjalë, të vendosura hapësira publike përkatesisht në drunjë të qytetit.

Me këtë rast parashtresi i ankesës thekson se nga ana e koalicionit LDK-AKR është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073 dhe konsideron se koalicioni LDK-AKR, sepse vendosja e posterve të kandidatit për deputet në drunjë të qytetit përben veprim të ndaluar pr subjektit politike, kandidat dhe mbështetësit e tyre. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektit Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë, koalicioni LDK-AKR i datës 09.06.2017, kanë theksuar se pas pranimit të ankesës i kemi urdhëruar kandidatin që të ndërmarrin veprime përmirësuese, pra nga këto veprime edhe është evituar shkelja sipas pretendimeve në ankesë. Koalicioni LDK-AKR, pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së kanë ndërmarr masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkangjitur tri fotografi nga vendi ku janë larguar posteret e kandidates lidhur me rastin në fjalë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterët e kandidatëve për deputet nga radhët e koalicionit LDK-AKR dega në Gjilan, janë vendosur në drunjë të qytetit pra në rrugën “Idriz Seferi”, në Gjilan, në hapësira apo vende publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit LDK-AKR, është shkelur nen 33 pika (b) i Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që posterët e kandidatëve për deputet nga koalicioni LDK-AKR, janë vendosur në drunjë të qytetit. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë koalicioni LDK-AKR, në përgjigjen në ankesë i datës 09.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondevë të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase koalicioni LDK-AKR kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti se poster të kandidatëve nga ky koalicion është vendosur në drunjë të qytetit pra në vende apo hapësira publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që koalicionit në fjalë ia dha mundësin për tu përgjigjur, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, ashtu që e kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa

Anr.173/2017 më datën 09.06.2017.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj



(Rafet Haxhaj)

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.